

*Lajm i mirë,  
gëzim i madh*



Libri *Lajm i mirë, gëzim i madh* na ballafaqon me një zbulim të freskët të lavdisë së Krishtlindjes. Për njerëz të zënë, si të gjithë ne, është një lehtësim i madh të ulemi dhjetë minuta përditë gjatë Adventit dhe të mendojmë për Jezusin Shpëtimtarin tonë—të çlodhemi, të ngazëllojmë, të ripërtërihemi!”

**Ray Ortlund**, pastor i pastorëve, Immanuel Church, Nashville, Tennessee

Si mund ta përjetojmë Adventin në një mënyrë të dobishme për shpirtin tonë pas datës 25 Dhjetor? Duke soditur dhe duke u kënaqur me lavdinë e Perëndisë në Krishtin e mishëruar, Shpëtimtarin, Zotin, Vëllanë dhe Mikun tuaj. Libri *Lajm i mirë, gëzim i madh* nga John Piper ju udhëheq në një eksplorim të lajmit të mirë të Krishtlindjes, duke ju ftuar t’i bashkoheni atij në një mrekullim, mahnitje dhe gëzim që ia tejkalon gëzimit të festës. Ky libër bën fjalë për gëzimin e përjetshëm dhe John Piper ju drejton tek ai gëzim, te vetë Jezu Krishti.”

**J. A. Medders**, autor, *Humble Calvinism*; pastor, Risen Church, Houston, Texas

Këto devocione për Adventin të shkruara nga pena e John Piper mund të jenë të shkurtra, por në to do të gjeni thellësinë dhe pasurinë e mendimit për të cilin njihet John Piper. Teksa marrim një ndjesi përndërimi plot gëzim, ai na kap për dore dhe na udhëheq në shenjtëroren e shenjtëroreve të mishërimit. Ndërsa ndalojmë në kroin e Birit që lindi për ne në Betlehem, jemi përgatitur që t’i vlerësojmë edhe më tepër dallgët e dashurisë në trajtën e tij të shpërfytyruar në Kalvar. Nëse doni që stina juaj e Krishtlindjes t’ju pasurojë nga ana frymërore marinojeni atë me mendimet e këtij libri!

**Conrad Mbewe**, pastor, *Kabwata Baptist Church*, Lusaka, Zambia

Ky libër është një sënduk i mbushur me të vërteta frymërore për Jezusin! Në këto devocione të shkurtra dhe prekëse, John Piper e ngre herë pas here vështrimin tonë për ta parë Krishtlindjen, ashtu sikurse duhet ta shohim në realitet—si lajmin e mirë të një gëzimi të madh për ju dhe mua. Ky libër është një ftesë për të njohur Birin e mishëruar, i cili u dërgua nga Ati në fuqinë e Frymës.

**Abigail Dodds**, autore, *(A) Typical Woman: Free, Whole, and Called in Christ*

**Libra të tjerë nga John Piper**

*Desiring God*

*Reading the Bible Supernaturally*

*Providence*

*Virusi korona dhe Krishti*

*Mos e shko dëm jetën*

*Pesë pika - Drejt një përjetimi më të thellë të hirit të Perëndisë*

# Lajm i mirë, gëzim i madh

*25 lexime devocionale për Adventin*

John Piper





Ky libër u mundësua në gjuhën shqipe nga Qendra “IGNIS”. Për më shumë materiale të tjera nga Qendra “IGNIS”, vizitoni faqen [www.dritez.al](http://www.dritez.al)

Good News of Great Joy: 25 Devotional Readings for Advent

Copyright © 2021 by Desiring God Foundation

Published by Crossway  
1300 Crescent Street  
Wheaton, Illinois 60187

Titulli në shqip:  
Lajm i mirë, gëzim i madh: 25 lexime devocionale për Adventin

Përktheu: Asim Hamza  
Redaktoi: Linea Simeon  
Korrektoi: Vilma Dina

Kopertina: Jordan Singer  
Përshtatja e faqosjes në shqip: Vision Printing shpk  
Shtypur në shtypshkronjën “Vision Printing shpk”

ISBN 978-9928-295-93-4

Tirazhi: 500 kopje

Të gjitha citimet biblike, nëse nuk thuhet ndryshe, janë marrë nga Bibla ABS 2009, përdorur me leje nga Albanian Bible Society (A.B.S.)

Të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të vendoset në ndonjë sistem ose të transmetohet nëpërmjet çdo forme apo mënyre elektronike, mekanike, fotokopjimi, inçizimi apo në ndonjë mënyrë tjetër pa marrë më parë leje me shkrim nga botuesi.

# Përmbajtja

Parathënie 9

Hyrje: Çfarë dëshiron Jezusi këtë Krishtlindje? 15

- Dita 1 Përgatit udhën (Luka 1:16–17) 21
- Dita 2 Perëndia i Madhërisëm i Marisë (Luka 1:46–55) 25
- Dita 3 Vizita e shumëpritur (Luka 1:68–71) 29
- Dita 4 Për njerëzit e vegjël të Perëndisë (Luka 2:1–5) 33
- Dita 5 Kalvari nuk anashkalohej (Luka 2:6–7) 37
- Dita 6 Paqe atyre me të cilët  
Perëndia është i kënaqur (Luka 2:12–14) 41
- Dita 7 Mesia për dijetarët (Mateu 2:1–2) 45
- Dita 8 Ylli i mbinatyrshëm i Betlehemit (Mateu 2:2) 49
- Dita 9 Dy lloj kundërshtimesh ndaj Jezusit (Mateu 2:3) 55
- Dita 10 Ar, livandë dhe mirrë (Mateu 2:10–11) 59
- Dita 11 Pse erdhi Jezusi? (Hebrenjve 2:14–15) 63
- Dita 12 Zëvendësimi i hijeve (Hebrenjve 8:1–2) 69
- Dita 13 Realiteti përfundimtar ka ardhur (Hebrenjve 8:1–2, 5) 73
- Dita 14 Përjetimi i realitetit  
për popullin e Tij (Hebrenjve 8:6) 77
- Dita 15 Jetë dhe vdekje në Krishtlindje (Gjoni 10:10) 81
- Dita 16 Tërheqja më e suksesshme  
e Perëndisë (Filipianëve 2:9–11) 85

- Dita 17 Shpëtimi më i madh  
që mund të përfytyrojmë (Jeremia 31:31) 89
- Dita 18 Modeli i Krishtlindjes  
për misionin (Gjoni 17:18) 95
- Dita 19 Krishtlindja ka të bëjë me lirinë (Hebrenjve 2:14–15) 99
- Dita 20 Solidariteti i Krishtlindjes (1 e Gjonit 3:8) 103
- Dita 21 Lindja e të Lashtit të ditëve (Gjoni 18:37) 107
- Dita 22 Që ju të besoni (Gjoni 20:30–31) 111
- Dita 23 Dhurata e papërshkrueshme  
e Perëndisë (Romakëve 5:10–11) 115
- Dita 24 Dy qëllime për Krishtlindjen (1 e Gjonit 3:7–8) 119
- Dita 25 Tri dhurata për Krishtlindje  
(1 e Gjonit 2:1–2; 3:7–8) 123
- Përfundim  
Teksti im i parapëlqyer i Krishtlindjes 129
- Shtojcë  
Hijet e Dhiatës së Vjetër dhe ardhja e Krishtit! 135



## Parathënie

**A**dventi ka të bëjë me adhurimin e Jezusit. Të paktën kështu e shohim në shërbesën e Desiring God.

Ai është një sezon i përvitshëm ku presim me durim e shpresë, hetojmë shpirtin dhe numërojmë ditët. Adventi mbahet nga shumë kisha, familje të krishtera dhe ndjekës të Jezusit. S'ka një urdhërim biblik për ndjekjen e Adventit. Është një traditë që u zhvillua përgjatë historisë së kishës si një kohë për t'u përgatitur për ditën e Krishtlindjes, ndaj është me zgjedhje. Shumë prej nesh e përjetojmë ndjekjen e Adventit si diçka sfiduese, të kënaqshme dhe të dobishme nga ana frymërore.

Fjala *advent* vjen prej latinishtes *adventus*, që do të thotë “ardhje”. Ardhja që kemi parasysh çdo dhjetor, është ardhja e parë e Jezusit dy mijë vjet më parë. Gjithsesi, këtu përfshihet edhe ardhja e dytë e Jezusit, ashtu siç thotë edhe një këngë e njohur për Krishtlindje:

Mos lër të rriten brengë e mëkat  
 Dhe tokën gjëmbat ta pushtojnë  
 Bekimet e Tij do të vërshojnë  
 Kudo ku mallkimi ka vënë dorë<sup>1</sup>

Adventi fillon të dielën e katërt para Krishtlindjes dhe mbaron në vigjiljen e saj. Kjo do të thotë se fillimi i Adventit varet nga e diela sipas kalendarit, që mund të jetë data 28 nëntor, ose data më e vonë, 5 dhjetor. Nëse periudha e Kreshmës (përgatitja për Pashkë) është dyzet ditë (duke shtuar edhe gjashtë të dielat), Adventi shkon nga njëzet e dy deri në njëzet e nëntë ditë.

Të krishterët anembanë botës kanë mënyra dhe manifestime të ndryshme fizike për kremtimin e Adventit. Disa ndezin qirinj, disa këndojnë këngë, disa hanë karamele. Disa japin dhurata ose varin kurora. Shumë prej nesh i bëjmë këto që përmendëm. Përgjatë shekujve kemi zhvilluar shumë mënyra të mira për ta zgjatur kremtimin e ardhjes së Jezusit përtej njëzet e katër orëve të shkurtra të 25 dhjetorit. Mishërimi i Birit të Perëndisë, “për ne dhe për shpëtimin tonë,” ashtu si thotë edhe kredoja e lashtë, është kaq domethënëse, sa nuk duhet vlerësuar thjesht në një ditë. Në të vërtetë, ne do ta kremtojmë për gjithë përjetësinë.

Lutemi që ky libërth me devocione do të të ndihmojë ta kesh Jezusin si qendrën dhe thesarin më të madh të sezonit të Adventit. Qirinjtë dhe karamelat e kanë vendin e tyre,

1 Isaac Watts, “Joy to the World,” 1719

por ne duam të sigurohemi që në mes të vrullit dhe ngarkesës së dhjetorit të vlerësojmë Jezusin mbi gjithçka tjetër.

Ja pse mendoj se kënga “Të shkojmë ta adhurojmë” mund të jetë kënga tematike për këto lexime Adventi.<sup>2</sup> Këto meditime kanë të bëjnë vetëm me adhurimin e Krishtit, Zotit. Me raste do të dëgjosh tinguj nga “O, eja eja Emanuel” dhe “Engjëjt lajmëtarë këndojnë”.<sup>3</sup> Sigurisht që dhe dijetarët hyjnë në skenë, por figura qendrore është Jezusi-foshnja e lindur në Betlehem, Perëndia-njeri i mbështjellë me pelena, i shtrirë në një grazhd, i destinuar për Kalvarin, i dërguar prej Atit që të vdesë dhe të ringjallet sërish për popullin e Tij.

Parathënia është mirë të lexohet para nisjes së Adventit (por edhe gjatë tij). Përfundimi mund të lexohet si një pjesë shtesë në ditën e Krishtlindjes (ose edhe para saj, veçanërisht nëse je kureshtar të dish tekstin e parapëlqyer të pastor John Piper për Krishtlindje). Shtojca për hijet e Dhiatës së Vjetër dhe për ardhjen e Krishtit koordinohet me meditimimin e ditës së 12-të (atje do të gesh një shënim referimi).

Perëndia e thelloftë dhe e ëmbëlsoftë adhurimin tënd për Jezusin gjatë këtij Adventi.

David Mathis  
*Redaktor ekzekutiv*  
*Desiring God*

2 John Francis Wade, “O Come, All Ye Faithful,” 1715

3 John Mason Neale, “O Come, O Come Emmanuel,” përkthyer në 1861; Charles Wesley, “Hark! The Herald Angels Sing” 1739







## Çfarë dëshiron Jezusi këtë Krishtlindje?

Çfarë dëshiron Jezusi këtë Krishtlindje? Përgjigjen e shohim në lutjet e Tij. Çfarë gjërash i kërkon Ai Perëndisë? Lutja e Tij më e gjatë është Gjoni 17 dhe kulmi i dëshirës së Tij është në vargun 24.

Mes gjithë mëkatarëve të padenjë në botë, gjenden ata të cilët Perëndia “ia ka dhënë” Jezusit. Këta janë njerëzit që Perëndia i ka tërhequr te Biri (Gjoni 6:44, 65). Këta janë të *krishterët*—njerëzit që e kanë *pranuar* Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin e kryqëzuar dhe të ringjallur, dhe si Thesarin e jetës së tyre (Gjoni 1:12; 3:17; 6:35; 10:11, 17-18; 20:28). Jezusi thotë se dëshiron që ata të jenë me Të.

Nganjëherë dëgjojmë njerëzit të thonë se Perëndia e krijoi njeriun për shkak se ndihej vetëm. Prandaj thonë: “Perëndia na krijoi që të ishim *me Të*.” A bie dakord Jezusi me këtë gjë? Në fakt, Ai *thotë* se dëshiron që ne të jemi me Të! Pa dyshim që po, por pse? Konsidero pjesën tjetër të vargut. Pse Jezusi dëshiron të jemi me Të?

...që ta shohin lavdinë time që ti [Atë] më dhe, sepse ti më deshe para themelimit të botës.

Kjo do të ishte një mënyrë e çuditshme për ta shprehur vetminë e Tij: “Dëshiroj që ata të jenë me mua, që të shohin lavdinë time.” Në fakt, kjo nuk shpreh vetminë e Tij, por interesimin e Tij për përmbushjen e ëndjes *sonë* dhe jo të vetmisë së *Tij*.

Jezusi nuk është i vetmuar. Ai, Ati dhe Fryma e Shenjtë janë thellësisht të kënaqur në bashkësinë e Trinisë. Ne jemi ata që po vdesim urie për diçka, jo Ai. Dëshira e Jezusit për këtë Krishtlindje është që ne të përjetojmë atë për të cilën vërtet u krijuam—të shohim dhe të shijojmë lavdinë e Tij.

Perëndia e ngulittë thellë këtë të vërtetë në shpirtin tonë! Jezusi na bëri që të shohim lavdinë e Tij (Gjoni 1:3).

Pak para se të shkonte në kryq, Jezusi iu përgjërta Atit me dëshirat e Tij më të thella: “O Atë, unë *dua* [dëshiroj] që... të jenë me mua që *ta shohin lavdinë time*.”

Kjo është vetëm gjysma e asaj që Jezusi dëshiron në këto vargje të fundit kulmore të lutjes së Tij. Sapo thashë që në të vërtetë ne u krijuam që ta shihnim *dhe ta shijonim* lavdinë e Tij. A është kjo çka Ai dëshiron—që jo vetëm ta shohim lavdinë e Tij, por edhe ta shijojmë atë, ta vlerësojmë, të kënaqemi, ta çmojmë dhe ta duam? Mendo për vargun 26, vargun e fundit të lutjes:

“Dhe i bëra të njohin emrin tënd dhe do të bëj ta njohin, që dashuria, me të cilën ti më deshe mua, të jetë në ta dhe unë në ta.”



Ky është fundi i lutjes së Tij. Cili është synimi *përfundimtar* i Jezusit për ne? Pra, synimi nuk është thjesht të shohim lavdinë e Tij, por ta duam Jezusin me të njëjtën dashuri që Ati e ka dashur: “që dashuria, me të cilën ti [Atë] më deshe mua, të jetë në ta dhe unë në ta.”

Dëshira dhe synimi i Jezusit është që ne ta shohim lavdinë e Tij, dhe pastaj do të jemi në gjendje ta duam atë që shohim, me të njëjtën dashuri që Ati ka për Birin. Ai nuk po thotë që thjesht të *imitojmë* dashurinë e Atit për Birin, por që vetë dashuria e Atit të bëhet dashuria jonë për Birin—që ne ta duam Birin me dashurinë që Ati ka për Të. Fryma bëhet dashuri dhe vendos dashurinë në jetën tonë: Dashurinë që Ati ka për Birin përmes Frymës.

Ajo që Jezusi dëshiron më tepër për Krishtlindje është që të zgjedhurit e Tij të mblidhen dhe të marrin çfarë *ata* dëshirojnë më tepër—së pari ta *shohin* dhe pastaj ta *shijojnë* lavdinë e Tij, ashtu si Ati kënaqet me Birin.

Ajo që dëshiroj më tepër për Krishtlindje këtë vit, është të bashkohem me ju (dhe shumë të tjerë) për ta parë Krish-tin në gjithë plotësinë e Tij dhe së bashku të jemi në gjendje ta duam atë çka shohim, me një dashuri shumë më të madhe se aftësitë tona njerëzore me gjysmë zemre. Ky është synimi ynë në këto meditime për Krishtlindje. Së bashku dëshirojmë të shohim dhe të shijojmë këtë Jezus, teksa festojmë adventin (ardhjen) e Tij të parë, ndërsa presim ardhjen e Tij të dytë.

Këtë lutje bën Jezusi për ne këtë Krishtlindje: “O Atë, u trego atyre lavdinë Time dhe u jep të njëjtën kënaqësi

që Ti ke në Mua.” E *pafshim* Krishtin me sytë e Perëndisë dhe e *shijofshim* atë me zemrën e Perëndisë. Ky është thelbi i qiellit. Kjo është dhurata, të cilën Krishti erdhi ta blejë për mëkatarët me çmimin e vdekjes së Tij në vendin tonë.





DITA I

## Përgatit udhën

**A**dventi mund të bëjë për ne atë që Gjon Pagëzori bëri për Izraelin. Mos lejo që Krishtlindja të të gjejë të papërgatitur, *frymërisht* të papërgatitur. Gëzimi dhe ndikimi i saj do të jetë shumë herë më i madh, nëse je gati!

Që të jesh *i përgatitur*...

Së pari, medito për faktin që kemi nevojë për një *Shpëtimtar*. Krishtlindja na padit, para se të na bëhet kënaqësi. “Sepse sot në qytetin e Davidit lindi për ju një *Shpëtimtar*, që është Krishti, Zoti” (Luka 2:11). Nëse s’ke nevojë për një Shpëtimtar, s’ke nevojë për Krishtlindjen. Ajo nuk do të ketë efektin e saj të dëshiruar derisa ta ndiejmë thellësisht nevojën për një Shpëtimtar. Lejoji këto meditime të shkurt-ra për Adventin të të ndihmojnë që brenda teje të rizgjohet ndjesia e hidhur dhe njëkohësisht e ëmbël e nevojës

Së dyti, përfshihu në një vetëshqyrtim të sinqertë. Periudha e pritjes së Adventit është pak a shumë siç është Kreshma për Pashkën. “Më heto, o Perëndi, dhe njihe zemrën time! / Më provo dhe njihi mendimet e mia! / Dhe shi-

ko në se ka tek unë ndonjë rrugë të keqe / dhe më udhëhiq nëpër rrugën e përjetshme.” (Psalmi 39:23-24). Çdo zemër le të *bëjë vend për Krishtin...* duke e pastruar shtëpinë.

Së treti, krijo një pritje dhe ngazëllim që ka Perëndinë në qendër të shtëpisë tënde—në mënyrë të veçantë të fëmijët. Nëse ti je i ngazëlluar për Krishtin, do të jenë edhe ata. Nëse mund ta bësh Krishtlindjen ngazëlluese vetëm me gjëra materiale, si do të fitojnë fëmijët një etje për Perëndinë? Vëre në punë imagjinatën që ta bësh të dukshme mrekullinë e ardhjes së Mbretit për fëmijët.

Së katërti, kaloni shumë kohë me Shkrimet dhe mësoni përmendsh pjesë të rëndësishme! “A nuk është fjala ime si zjarri?”, thotë Zoti (Jeremia 23:29). Mblidhuni rreth atij zjarri këtë stinë të Adventit. Është ngrohtë, shkëlqen ngjyrat e hirit, është shërim për një mijë lëndime dhe dritë për netët e errëta.







## DITA 2

# Perëndia i Madhërishëm i Marisë

**M**aria sheh qartë diçka tepër të jashtëzakonshme rreth Perëndisë: Ai po bëhet gati të ndryshojë drejtimin e gjithë historisë njerëzore; tri dekadat më të rëndësishme në të gjitha kohërat janë gati për të filluar..

Ku është Perëndia? Ai po punon me dy gra të panjohura dhe të përlulura, njëra plakë dhe shterpë (Elizabeta), dhe tjetra e re dhe virgjëreshë (Maria). Maria preket aq shumë prej këtij vizioni të Perëndisë, prej Atij që i do të përlulurit, saqë shpërthen në këngë, një këngë e cila njihet me emrin “Manjifikati”.

Maria dhe Elizabeta janë heroina të mrekullueshme në tregimin e Lukës. Atij i pëlqen besimi i këtyre grave. Çfarë i bën më tepër përshtypje dhe që dëshiron t’ia ngulitë në mendje Teofilit, këtij lexuesi fisnik, duket se është përlulësia e gëzueshme e Elizabetës dhe Marisë, ndërsa ato i nënshtrohen Perëndisë së tyre madhështor.

Elizabeta thotë (Luka 1:43): “Dhe nga po më ndodh kjo, që nëna e Zotit tim të vijë tek unë?” Dhe Maria thotë

(Luka 1:48): “Ai e shikoi me pëlqim përulësinë e shërbëtores së tij.”

Të vetmit njerëz, shpirti i të cilëve mund ta madhërojë me të vërtetë Perëndinë, janë njerëzit si Elizabeta dhe Maria, njerëz të cilët e pranojnë gjendjen e tyre të përulur dhe mahniten që Perëndia i madhërishëm i përfill.





## Vizita e shumëpritur

Vërejmë dy gjëra të jashtëzakonshme te Luka 1:68-71 nga fjalët e Zakarias, bashkëshortit të Elizabetës.

Së pari, nëntë muaj më herët, Zakaria s'pati besim se gruaja e tij do të lindte një fëmijë. Tani i mbushur me Frymën e Shenjtë, ai është aq i sigurt për veprën shpenguese të Perëndisë në ardhjen e Mesias, saqë e vendos këtë në kohën e shkuar: “E ka vizituar dhe i bëri shpengim popullit të vet.” Për mendjen e besimit, një veprim që Perëndia ka premtuar, është i kryer tashmë. Zakaria kishte mësuar t’i zinte besë fjalës së Perëndisë, prandaj ka një siguri të jashtëzakonshme: Perëndia “e ka vizituar dhe i bëri shpengim popullit të vet” (Luka 1:68).

Së dyti, ardhja e Jezus Mesias është vizita e Perëndisë në botën tonë: *Perëndia i Izraelit* “e ka vizituar dhe i bëri shpengim popullit të vet.” Për shekuj me radhë, populli jude kishte lënguar nën bindjen se Perëndia ishte tërhequr; fryma e profecisë ishte shuar dhe Izraeli kishte rënë në duart e Romës. Të gjithë njerëzit e perëndishëm në Izrael po prisnin vizitën e Perëndisë. Luka na thotë se një tjetër

### DITA 3

burrë i moshuar, Simeoni i devotshëm, ishte “duke pritur shpengimin e Izraelit” (Luka 2:25). Po ashtu Ana që lutej në tempull, po priste “shpengim në Jerusalem” (Luka 2:38).

Ato ishin ditë pritjesh të mëdha. Vizita e shumëpritur e Perëndisë po bëhej realitet—me të vërtetë, Ai po vinte ashtu si askush s’e priste.







## DITA 4

# Për njerëzit e vegjël të Perëndisë

**A**e ke menduar ndonjëherë sa e mahnitshme është që Perëndia e caktoi më përpara që Mesia të lindte në Betlehem (ashtu si na tregon profecia e Mikeas 5)? A të ka mahnitur fakti që Ai i caktoi gjërat në atë mënyrë që kur të vinte koha, nëna e Mesias dhe babi i tij ligjor të mos jetonin në Betlehem, por në Nazaret? Po për faktin që për të përmbushur fjalën e Tij dhe për t'i sjellë këta dy njerëz të panjohur, të parëndësishëm dhe të vegjël në Betlehem atë Krishtlindje të parë, Perëndia vendosi në zemrën e Cezar Augustit që e gjithë perandoria romake të regjistrohej, secili në qytetin e tij? Një dekret për të gjithë botën që dy njerëz të bëjnë 110 kilometra rrugë!

A je ndier ndonjëherë si unë, i vogël dhe i parëndësishëm në një botë me shtatë miliardë njerëz, ku të gjitha lajmet janë vetëm për lëvizjet e mëdha politike, ekonomike dhe shoqërore, si dhe për njerëzit e jashtëzakonshëm, të famshëm për botën dhe me shumë pushtet e prestigj? Nëse je ndier kështu, mos u dekurajo dhe mos u mërzit. Në Shkrime

nënkuptohet se të gjitha forcat gjigante politike dhe të gjithë kompleksët e mëdha industriale, madje pa dijeninë e tyre, po drejtohen prej Perëndisë, jo për hir të tyre, por për hir të njerëzve të thjeshtë të Perëndisë–Marisë së vogël dhe Jozefit të vogël, që duhet të shkojnë nga Nazareti në Betlehem. Perëndia vë në lëvizje një perandori të tërë për të përm-bushur fjalën e Tij dhe për të bekuar fëmijët e Tij.

Mos mendo se për shkak se përjeton armiqësi në botën e vogël të përvojave të tua, dora e Zotit është shkurtuar. Me gjithë zemrën e Tij, Ai po kërkon shenjterinë tonë, jo begatinë apo famën tonë. Dhe me këtë synim në mendje, Ai e sundon gjithë botën. Ashtu si na thuhet te Fjalët e Urta 21:1: “Zemra e mbretit në duart e Zotit është si rrjedhat e ujit; atë e drejton ngado që do ai.”

Ai është një Perëndi i madh për njerëz të vegjël dhe ne kemi një arsye të madhe për t’u ngazëlluar, që edhe pa e ditur ne, të gjithë mbretërit, presidentët, kancelarët dhe kryeministrat e botës ndjekin dekretet sovrane të Atit tonë në qiell, që ne, fëmijët e Tij, të mund të përshtatemi me shëmbëllimin e Birit të Tij, Jezu Krishtit, dhe më pas të hymë në lavdinë e Tij të përjetshme.





## Kalvari nuk anashkalohe

**N**doshta mendon se, nëse Perëndia e sundon botën në Natë mënyrë sa të përdorë numërimin e popullsisë të një perandorie për ta çuar Marinë dhe Jozefin në Betlehem, sigurisht që Ai mund t'u siguronte një dhomë në han.

Patjetër që mund ta bënte! Pa diskutim që Ai mund ta bënte! Jezusi *mund* të kishte lindur në një familje të pasur dhe *mund* t'i kishte kthyer gurët në bukë në shkretëtirë. Ai *mund* të kishte thirrur dhjetë mijë engjëj që t'i vinin në ndihmë në Gjetsemani. Jezusi *mund* të kishte zbritur nga kryqi dhe ta kishte shpëtuar veten, ndaj pyetja s'është çfarë *mund* të bëjë Perëndia, por çfarë *vendosi* të bënte.

Vullneti i Perëndisë ishte që, edhe pse Krishti ishte i pasur, për hirin tonë Ai u bë i varfër. Shenjat "S'kemi dhoma të lira!" te hyrjet e të gjitha haneve në Betlehem ishin *për hirin tuaj*. "Ai u bë i varfër për ju" (2 e Korintasve 8:9).

Perëndia sundon mbi të gjitha gjërat, edhe mbi kapacitetet e hoteleve dhe shtëpive me qira ditore, për hir të fëmijëve të Tij. Rruga e Kalvarit nis me tabelën "S'kemi

dhoma të lira.” në Betlehem dhe përfundon me talljet dhe pështymat ndaj kryqit në Jerusalem.

Nuk duhet të harrojmë se Jezusi tha: “Nëse dikush do të vijë pas meje, le ta mohojë vetveten, ta marrë çdo ditë kryqin e vet dhe të më ndjekë” (Luka 9:23).

Ne i bashkohemi Jezusit në rrugën e Kalvarit dhe e dëgjojmë tek na thotë: “Kujtoni fjalën që unë ju thashë: ‘Shërbëtori nuk është më i madh se i zoti i tij’. Nëse më kanë përndjekur mua, do t’ju përndjekin edhe ju” (Gjoni 15:20).

Atij që thërret me entuziazëm: “Zot, unë do të të ndjek kudo që të shkosh,” Jezusi i përgjigjet: “Dhelprat kanë strofka dhe zogjtë e qiellit kanë fole, kurse Biri i njeriut nuk ka ku të mbështesë kryet” (Luka 9:57-58).

Po, Perëndia mund të ishte kujdesur që Jezusi të kishte një dhomë për lindjen e Tij, por kjo do ta kishte anashkaluar Kalvarin.







## DITA 6

# Paqe atyre me të cilët Perëndia është i kënaqur

**P**ër kë ka paqe? Në lavdërimin e engjëjve ka një notë serioze. Paqe mbi dhe njerëzve mbi të cilët qëndron pëlqimi Tij. Paqe mes njerëzve me të cilët Ai është i kënaqur. Ama pa besim është e pamundur t'i pëlqesh Perëndisë (Hebrenjve 11:6). Ja pse Krishtlindja nuk u sjell paqe të gjithëve.

Jezusi tha: “Tani gjyqi është ky: Drita erdhi në botë dhe njerëzit deshën errësirën më tepër se dritën, sepse veprat e tyre ishin të mbrapshta” (Gjoni 3:19). Ose siç tha dhe Simeoni plak kur pa foshnjën Jezus: “Ja, ky është vënë për rënien dhe për ngritjen e shumë *vetave* në Izrael dhe për të qenë shenjë e të folurit kundër...që të zbulohen mendimet e shumë zemrave” (Luka 2:34-35). Oh, sa të shumtë janë ata që hedhin vështrimin jashtë në një ditë të zymtë dhe të ftohtë Krishtlindjeje dhe nuk dallojnë asgjë më tepër sesa thjesht një shenjë për t'u kundërshtuar.

“Ai erdhi te të vetët dhe të vetët nuk e pranuan, por të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij

të Perëndisë, atyre që *besojnë* në emrin e tij” (Gjoni 1:11-12). Vetëm dishepujve të Tij Jezusi u tha: “Paqen po ju lë, paqen time po jua jap: unë jua jap *por* jo siç jep bota; zemra juaj mos u trondittë dhe mos u frikësoftë” (Gjoni 14:27).

Njerëzit që gëzojnë paqen e Perëndisë, e cila ia tejkalon çdo zgjuarsie, janë ata që në gjithçka me anë lutjesh dhe përgjërimesh ia bëjnë të njohura kërkesat e tyre Perëndisë (Filipianëve 4:6-7).

Çelësi që hap sëndukun e thesareve të paqes së Perëndisë, është besimi në premtimet e Tij. Prandaj Pali thotë: “Dhe Perëndia i shpresës le t’ju mbushë me çfarëdo gëzimi dhe paqeje në *besim*, që të keni mbushulli në shpresë, me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë!” (Romakëve 15:13). Kur ne *i besojmë* premtimet e Perëndisë dhe kemi gëzim, paqe dhe dashuri, atëherë Perëndia përlëvdohet.

Lavdi Perëndisë në vendet më të larta, dhe paqe mbi dhe, pëlqim ndër njerëzit! Për këdo—nga çdo popull, gjuhë, fis dhe komb—për këdo që do të besojë.





DITA 7

## Mesia për dijetarët

**N**dryshe nga Luka, Mateu nuk na tregon për barinj-të, që vijnë të vizitojnë Jezusin në grazhd. Fokusi i tij shkon menjëherë te të huajt–johebrenjtë, jojudenjtë–të cilët vijnë nga lindja për të adhuruar Jezusin.

Prandaj Mateu e portretizon Jezusin në fillim dhe në fund të ungjillit të tij si një Mesia universal për të gjitha kombet dhe jo thjesht për judenjtë.

Në këtë rast, adhuruesit e parë janë magjistarë të oborrit mbretëror, astrologë ose njerëz të urtë dhe jo nga Izraeli, por nga lindja–ndoshta nga Babilonia. Ata ishin johebrenj, të papastër sipas ligjeve ceremoniale të Dhiatës së Vjetër.

Në fund të librit të Mateut, fjalët e fundit të Jezusit janë: “Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë. Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë kombet” (Mateu 28:18-19).

Kjo porosi nuk hapi vetëm derën që ne johebrenjtë të ngazëllojmë në Mesian; ajo ishte një provë shtesë që Jezusi ishte Mesia, sepse, në fakt, një prej profecive të përsëritura

## DITA 7

ishte se mbretërit dhe kombet do të vinin tek Ai si sundimtari i botës. Për shembull, Isaia 60:3 thotë:

Kombet do të ecin në dritën tënde  
dhe mbretërit në shkëlqimin e daljes sate.

Prandaj Mateu shton prova për identitetin mesianik të Jezusit *dhe* tregon se Ai është Mesia—një Mbret dhe plotësues i premtimeve—për të gjitha kombet, jo vetëm për Izraelin.







## Ylli i mbinatyrshëm i Betlehemit

**H**erë pas here, Bibla na ngjall kuriozitetin për mënyrën si ndodhën gjëra të caktuara. Si i solli ky “yll” dijetarët nga lindja në Jerusalem?

Nuk thuhet se ylli i udhëhoqi apo shkoi para tyre rrugës për në Jerusalem. Thuhet vetëm se ata panë një yll në lindje (vargu 2) dhe erdhën në Jerusalem. Si shkoi ylli para tyre ato nëntë kilometra nga Jerusalemi në Betlehem siç thotë Mateu 2:9? Si “qëndroi përmbi vendin ku ndodhej fëmija”?

Përgjigja është: Nuk e dimë! Ka pasur shumë përpjekje për ta shpjeguar përmes mbivendosjes së planetëve, kometave, shpërthimeve yjore apo dritave të mrekullueshme. Ne thjesht nuk e dimë. Dua të të këshilloj të mos preokupohesh së tepërmi, të mos fiksohesh me teoritë që janë thjesht tentativa në fund të fundit, dhe kanë fare pak domethënie frymërore.

Ka rrezik që po bëj një përgjithësim me këtë paralajmërim: njerëzit që merren dhe preokupohen si funksionoi puna e yllit, si u nda Deti i Kuq, si ra mana nga qielli, si

mbijetoi Jona në barkun e peshkut dhe si hëna kthehet në gjak, janë në përgjithësi njerëz që kanë një mentalitet për vogëlsirat e parëndësishme, siç i quaj unë.

Te njerëz të tillë nuk dallon një vlerësim të thellë për të vërtetat qendrore të ungjillit—për shenjtërinë e Perëndisë, për shëmtinë e mëkatit, për pafuqinë e njeriut, për vdekjen e Krishtit, për drejtësimin vetëm me anë të besimit, për punën shenjtëruese të Frymës, për lavdinë e kthimit të Krishtit ose për gjykimin përfundimtar. Gjithashtu duket se ata të udhëheqin nëpër një shteg tjetër anësor me një artikull apo libër të ri me të cilin janë të ngazëlluar, por që trajton diçka të parëndësishme. Te këta njerëz ka pak ngazëllim për gjërat e mëdha dhe qendrore.

Gjithsesi, është e qartë se ylli po bën diçka të cilën nuk mund ta bënte vetë: po i drejtonte dijetarët te Biri i Perëndisë, në mënyrë që ata ta adhuronin.

Në botëkuptimin biblik ka vetëm një person pas qeverisjes së qëllimshme të yjeve: Vetë Perëndia.

Prandaj, mësimi është i qartë: Perëndia po i udhëzon të huajt te Krishti që ata ta adhurojnë Atë. Për këtë, Perëndia ushtron ndikim dhe fuqi globale—ndoshta dhe universale.

Luka tregon se Perëndia ndikoi gjithë Perandorinë Romake që numërimi të ndodhte në kohën e caktuar, për të bërë që një virgjëreshë e thjeshtë nga Betlehem të plotësojë profecinë me lindjen e fëmijës së saj. Mateu tregon se si Perëndia ndikon te yjet e qiellit për t'i çuar dijetarët e huaj në Betlehem, në mënyrë që të adhurojnë Birin.

Ky është projektimi i Perëndisë. Ai e bëri atëherë dhe po

vazhdon ta bëjë dhe tani. Synimi i Tij është që kombet—të gjitha kombet (Mateu 24:14)—ta adhurojnë Birin e Tij.

Ky është vullneti i Perëndisë për këdo në zyrën tënde të punës, në klasën tënde, në lagjen dhe familjen tënde. Ashtu si thotë dhe Gjoni 4:23: “sepse Ati kërkon të tillë si adhurues të tij.”

Në fillim të librit të Mateut kemi ende një model “eja dhe shih”, por në fund modeli është “shko dhe trego”. Dije-tarët erdhën dhe panë. Ne duhet të shkojmë dhe të tregojmë.

Gjithsesi çfarë nuk ndryshon, është qëllimi dhe fuqia e Perëndisë për t’i mbledhur kombet që të adhurojnë Birin e Tij. Madhërimi i Krishtit në adhurimin e flaktë të të gjitha kombeve është arsyeja pse bota ekziston.







## DITA 9

# Dy lloj kundërshtimesh ndaj Jezusit

Jezusi i shqetëson njerëzit që nuk duan ta adhurojnë Atë dhe sjell kundërshtim për ata që duan ta adhurojnë. Mund të mos jetë kjo pika kryesore në mendjen e Mateut, por është rrjedhoja e pashmangshme e shpalosjes së historisë.

Në këtë histori ka dy lloje njerëzish që nuk duan ta adhurojnë Jezusin.

Lloji i parë janë ata që thjesht nuk bëjnë asgjë me Jezusin. Ai është askushi për ta. Ky grup përfaqësohet në fillim të jetës së Jezusit nga krerët e priftërinjve dhe skribët. Mateu 2:4 thotë: “Dhe, pasi i mbloodhi të gjithë kryepriftërinjtë dhe skribët e popullit, (Herodi) u kërkoi ku duhet të lindte Krishti.” Kështu ata i treguan dhe kaq: pastaj iu kthyen punës si normalisht. Heshtja e plotë dhe mosveprimi i udhëheqësve është e habitshme, nën dritën e madhështisë së asaj që po ndodhte.

Vini re që Mateu 2:3 thotë: “Por mbreti Herod, kur i dëgjoi këto fjalë u shqetësua, dhe mbarë Jerusalemi bashkë

me të.” Me fjalë të tjera, po përhapeshin fjalë që dikush kish thënë se Mesia kishte lindur. Mosveprimi nga ana e kryepriфтërinjve është tronditës: pse nuk shkuan me dijetarët? Ata nuk kanë interes. Ata nuk kanë pasion për ta gjetur Birin e Perëndisë dhe për ta adhuruar Atë.

Lloji i dytë i njerëzve, të cilët nuk duan ta adhurojnë Jezusin, janë ata që ndihen shumë të kërcënuar prej Tij. Në këtë histori, ky është Herodi. Ai është tepër i frikësuar—aq sa komploton, gënjen dhe pastaj kryen një gjenocid, thjesht për ta hequr qafe Jezusin.

Po kështu edhe sot, këto dy lloj kundërshtimesh do të ngrihen kundër Krishtit dhe adhuruesve të Tij: shpërfillja dhe armiqësia. Vërtet shpresoj që ti të mos jesh në ndonjërin prej këtyre grupeve.

Nëse je i krishterë, lejo që kjo Krishtlindje të jetë koha kur ti mediton mbi kuptimin dhe çmimin që ka adhurimi dhe ndjekja e Mesias.







## Ar, livandë dhe mirrë

**P**erëndia nuk shërbehet prej duarve të njerëzve sikur të kishte nevojë për ndonjë gjë (Veprat 17:25). Dhuratat e dijetarëve nuk iu dhanë Jezusit për ta ndihmuar apo për t'ia plotësuar nevojat. Ishte çnderuese për një monark që vizitorë të huaj t'i sillnin pako me dhurata mbretërore.

Këto dhurata nuk ishin as formë ryshfeti. Ligji i Përtërirë 10:17 thotë se Perëndia nuk merr ryshfete. Epo, çfarë kuptimi kanë ato vallë? Si na qenkan adhurim?

Dhuratat që u jepen njerëzve të pasur dhe që kanë mjaftueshëm, tregojnë një jehonë dhe intensifikim të dëshirës së dhuruesit për të treguar sa i mrekullueshëm është personi që po i dhurohen këto dhurata. Në njëfarë kuptimi, t'i japësh dhurata Krishtit është si agjërimi—të privosh veten nga diçka për të treguar se Krishti është më i vlefshëm nga ajo që po e privon veten.

Kur i jep një dhuratë Krishtit, është si t'i thuash: “Gëzimi që po kërkoj (Mateu 2:10 thotë: “Por, kur e panë yllin, u gëzuan me gëzim shumë të madh”), nuk është shpresa

që të bëhem i pasur duke shkëmbyer dhurata me Ty apo duke biseduar për ndonjë pagesë. Nuk kam ardhur tek Ti për *gjërat* e Tua, por për *Ty*. Këtë dëshirë po e intensifikoj dhe po e demonstroj duke dorëzuar *gjëra*, me shpresën që do të kënaqem më tepër me Ty. Duke të dhënë Ty atë për të cilën nuk ke nevojë, por me të cilën mund të kënaqem, po them me më tepër vërtetësi dhe dëshirë: “Ti je thesari im dhe jo këto gjëra.”

Mendoj se kjo është ajo çfarë do të thotë ta adhurosh Perëndinë me dhurata ari, livande dhe mirre. Apo me çfarë-dolloj gjëje tjetër që mund të mendojmë t’i japim Perëndisë.

Zgjoftë Perëndia brenda nesh një dëshirë për vetë Krish-tin dhe thënçim edhe ne nga zemra: “Zot Jezus, Ti je Mesia, Mbreti i Izraelit. Të gjitha kombet do të vijnë dhe do të përulen para Teje. Perëndia vë në lëvizje gjithë botën, për t’u siguruar që të adhurohesh. Prandaj çfarë-dolloj kundërshtimi që mund të has, me gëzim të jap autoritetin dhe dinjitetin Ty dhe të sjell dhuratat e mia për të thënë se vetëm Ti mund ta kënaqësh zemrën time.”





## DITA I I

# Pse erdhi Jezusi?

**H**ebrenjve 2:14-15, mendoj se është teksti im më i parapëlqyer rreth Adventit, sepse nuk njoh asnjë tekst tjetër që e shpreh kaq qartë lidhjen mes fillimit dhe fundit të jetës tokësore të Jezusit—mes mishërimit dhe kryqëzimit. Këto dy vargje e bëjnë të qartë arsyen pse Jezusi erdhi për të vdekur këtu në tokë. Ato mund të përdoren shumë mirë me një mik apo familjar që nuk beson, për t’i udhëhequr hap pas hapi në pikëpamjen tënde të krishterë për Krishtlindjen. Biseda mund të bëhet frazë pas fraze:

Sepse, duke qenë se bijtë kanë marrë pjesë prej mishi dhe gjaku...

Termi “bijtë” vjen nga vargu pararendës (Hebrenjve 2:13) dhe i referohet pasardhësve frymërorë të Krishtit, Mesias (shih Isaia 8:18; 53:10). Këta janë gjithashtu “bijtë e Perëndisë” (Gjoni 1:12). Me fjalë të tjera, me dërgimin

e Krishtit, Perëndia ka për qëllim veçanërisht shpëtimin e “bijve” të Tij.

Është e vërtetë që “Perëndia e deshi aq *botën* sa dha [Jezusin]” (Gjoni 3:16), por është gjithashtu e vërtetë që Perëndia po mblidhte *veçanërisht* “bijtë e Perëndisë që ishin të shpërndarë” (Gjoni 11:52). Plani i Perëndisë ishte t’i *ofronte* botës Krishtin dhe të *shkaktonte* shpëtimin e bijve të Tij (shih 1 e Timoteut 4:10). Mund të përjetosh birësimin nga Perëndia duke pranuar Krishtin (Gjoni 1:12):

...po ashtu edhe ai u bë pjesëtar në po ato gjëra [mish dhe gjak]...

Kjo do të thotë se Krishti ekzistonte para mishërimit. Ai ishte frymë, Ai ishte Fjala e përjetshme, Ai ishte me Perëndinë dhe ishte Perëndi (Gjoni 1:1, Kolosianëve 2:9). Prapëseprapë, Ai mori mish dhe gjak, dhe kështu e veshi hyjninë e Tij me natyrë njerëzore. Ai u bë plotësisht njeri dhe mbeti plotësisht Perëndi. Ky është një mister i madh në shumë mënyra, por kjo e vërtetë qëndron në zemrën e besimit tonë dhe Bibla këtë na mëson.

... që...me anë të vdekjes...

Arsyeja pse Krishti u bë njeri, ishte që të vdiste. Si Perëndi, thjesht dhe qartë, Ai nuk mund të vdiste dot për mëkatarët, por si njeri mund ta bënte. Synimi i Tij ishte të vdiste, prandaj duhej të lindte si njeri. Ai lindi për të



vdekur. E premtja e mirë është arsyeja e Krishtlindjes. Ja çfarë kanë nevojë të dëgjojnë shumica e njerëzve sot për kuptimin e Krishtlindjes.

...që të shkatërronte... atë që ka pushtetin e vdekjes,  
domethënë djallin...

Duke vdekur, Krishti e çarmatosi djallin. Si e bëri Ai këtë? Duke i mbuluar të gjitha mëkatet tona. Kjo do të thotë se satani nuk ka asnjë bazë të ligjshme për të na akuzuar para Perëndisë. “Kush do t’i padisë të zgjedhurit e Perëndisë? Perëndia është ai që i shfajëson.” (Romakëve 8:33)—mbi çfarë baze i shfajëson Ai? Përmes gjakut të Jezusit (Romakëve 5:9).

Arma përfundimtare e satanit kundër nesh është vetë mëkati ynë. Nëse vdekja e Krishtit e heq mëkatin, djallit i hiqet nga duart arma e tij kryesore—e vetmja armë vdekjeprurëse që ai ka. Ai nuk mund të na akuzojë për të na dënuar me vdekje, për shkak se Gjykatësi na ka shfajësuar përmes vdekjes së Birit të Tij!

...edhe të çlironte të gjithë ata që nga frika e vdekjes i  
ishin nënshtruar robërisë për tërë jetën.

Ne, pra, jemi të lirë prej frikës së vdekjes. Perëndia na ka shfajësuar. Satani nuk mund ta shfuqizojë dot atë dekret. Perëndia ka për qëllim që siguria jonë *përfundimtare* të ketë një efekt të menjëhershëm në jetën tonë. Ai ka për qëllim

që fundi i lumtur të heqë qafe skllavërinë dhe frikën tonë të tanishme.

Nëse nuk ka arsye pse të kemi frikë prej armikut tonë të fundit dhe më të madh, vdekjes, atëherë nuk ka pse të kemi frikë nga asnjë gjë. Ne mund të jemi të lirë, të lirë për t'u gëzuar, të lirë për të tjerët.

Çfarë dhurate të madhe Krishtlindjeje na ka dhënë Perëndia! Çfarë dhurate të madhe që ne mund t'i japim botës!





## Zëvendësimi i hijeve

**T**heksi i librit të Hebrenjve është se Jezu Krishti, Biri i Perëndisë, nuk erdhi thjesht që të përputhej me sistemin tokësor të shërbesës priftërore si prifti njerëzor më i mirë dhe përfundimtar. Ai erdhi që ta përmbushte, t'i jepte fund atij sistemi dhe ta drejtonte gjithë vëmendjen tonë te vetja e Tij. Ai shërbeu për ne së pari në kryqin e Kalvarit, si flijimi ynë final, dhe dhe më pas në qiell si prifti ynë final.

Tabernakulli i Dhiatës së Vjetër, priftërinjtë dhe flijimet ishin hije. Tani realiteti ka ardhur dhe hijet kanë kaluar.

Këtu kemi një shembull të Adventit për fëmijët—dhe për secilin prej nesh që kemi qenë fëmijë dhe e mbajmë mend si ka qenë. Përfytyro sikur të ndaheshe nga mami në një dyqan ushqimorësh. Fillon të frikësohesh dhe të kap paniku, nuk e di nga të shkosh; shkon deri në fund të një rrugice dhe pak para se të fillosh të qarat, sheh në tokë, atje në fund të rrugicës, një hije që duket tamam si mamaja juaj. Ti lumturohesh së tepërmi dhe tani ndien shpresë.

Por cila është më e mirë? Lumturia e të parit të hijes apo mamaja që del nga cepi?

Kështu është edhe me rastin kur Jezusi vjen të jetë Kryepifti ynë i madh. Kjo është Krishtlindja. Krishtlindja është zëvendësimi i hijeve me realitetin: Mami që shfaqet nga cepi i rrugicës dhe gjithë lehtësimi dhe gëzimi që kjo gjë i sjell një fëmije të vogël.

(Për të mësuar më tepër se si ardhja e Krishtit e zëvendëson Dhiatën e Vjetër, shihni shtojcën në fund të këtij libri.)







## Realiteti përfundimtar ka ardhur

**E** thamë edhe më herët, por ka akoma. Krishtlindja është zëvendësimi i hijeve me atë që është e vërtetë. Hebrenjve 8:1-2, 5 është pak a shumë një deklaratë përmbledhëse. Ideja është që prifti, i cili ndërmjetëson për ne para Perëndisë, që na bën të drejtë para Tij dhe që i lutet Perëndisë për ne, nuk është një prift i zakonshëm, i dobët, mëkatar dhe vdekatar, si në kohën e Dhiatës së Vjetër. Ai është Biri i Perëndisë—i fortë, pa mëkat dhe me një jetë të pashkatërrueshme.

Jo vetëm kaq, por Ai nuk po shërben në një tabernakull tokësor, me tërë kufizimet e vendit dhe madhësisë, një tabernakull që shkatërrohet, që brehet prej tenjës, që laget, digjet dhe vidhet. Jo, Hebrenjve 8:2 thotë se Krishti po shërben për ne në “tabernakullin e vërtetë, të cilin e ngriti Perëndia e jo njeriu”. Kjo nuk është hije, kjo është diçka reale në qiell. Ky është realiteti, hija e të cilit ra mbi Malin Sinai që Moisiu ta kopjonte.

Sipas Hebrenjve 8:1, diçka tjetër madhështore për re-

alitetin që është më i madh se hija, është se Kryepriifti ynë është ulur në të djathtë të Madhërisë në qiej. Asnjë prift i Dhiatës së Vjetër nuk mund ta thoshte dot kurrë këtë gjë.

Jezusi merret drejtpërdrejt me Perëndinë Atë. Ai ka një vend nderi përkrah Perëndisë. Ai është i dashur dhe i respektuar pafundësisht prej Perëndisë. Jezusi është vazhdimisht me Perëndinë. Kjo nuk është hija e realitetit siç ishin perdet, legenët, tryezat, qirinjtë, rrobat, kupat, delet, dhitë dhe pëllumbat. Ky është realiteti final dhe përfundimtar: Perëndia dhe Biri i Tij që bashkëveprojnë në dashuri dhe shenjtëri për shpëtimin tonë të përjetshëm.

Realiteti përfundimtar ka të bëjë me personat e Hyjnisë, të cilët janë në marrëdhënie bashkëveprimi me njëri-tjetrin për manifestimin e madhështisë, shenjtërisë, dashurisë, drejtësisë, mirësisë dhe së vërtetës së tyre në një popull të shpenguar.





DITA 14

## Përjetimi i realitetit për popullin e Tij

**K**rishti është Ndërmjetësi i besëlidhjes së re, sipas Hebrenjve 8:6. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë se gjaku i Tij–gjaku i besëlidhjes (Luka 22:20; Hebrenjve 13:20)–bleu dhe siguroi përfundimisht dhe me siguri të plotë plotësimin e premtimeve të Perëndisë për ne.

Kjo do të thotë se Perëndia, sipas premtimeve të besëlidhjes së re, sjell transformimin tonë të brendshëm përmes Frymës së Krishtit.

Kjo do të thotë gjithashtu se Perëndia e arrin këtë transformim në ne përmes besimit–besim në atë që Perëndia është për ne në Krishtin.

Besëlidhja e re është blerë me *gjakun* e Krishtit, bëhet e efektshme përmes *Frymës* së Krishtit dhe përvetësohet me anë të *besimit* në Krishtin.

Vendi më i mirë për ta parë Krishtin të punojë si ndërmjetësi i besëlidhjes së re është Hebrenjve 13:20-21:

Dhe Perëndia i paqes, që e nxori lart prej së vdekurish,

me anë të gjakut të besëlidhjes së amshuar, Bariun e madh të dhenve, Zotin tonë Jezu Krisht, ju bëftë të përsosur për çdo vepër të mirë, që të kryeni vullnetin e tij, duke punuar në ju atë që është e pëlqyer përpara tij, *përmes Jezu Krishtit*, të cilit i qoftë lavdi në jetë të jetëve. Amen.

Fjalët “duke punuar në ju atë që është e pëlqyer përpara tij” përshkruajnë çfarë ndodh kur Perëndia e shkruan ligjin në zemrat tona në përputhje me besëlidhjen e re. Dhe fjalët “përmes Jezu Krishtit,” përshkruajnë Jezusin si ndërmjetësin e kësaj vepre të lavdishme të hirit të Tij sovran.

Prandaj, kuptimi i Krishtlindjes nuk është vetëm që Perëndia i zëvendëson hijet me realitetin, por gjithashtu që e sjell në jetë realitetin për popullin e Tij. Ai e shkruan në zemrat tona. Perëndia nuk e vendos dhuratën e Krishtlindjes, shpëtimin dhe transformimin poshtë një peme, nëse mund ta themi kështu, që ta marrësh me fuqitë e tua. Ai e merr dhe e vendos në zemrën dhe mendjen tënde dhe të jep vulën e sigurisë që je një fëmijë i Perëndisë.







## Jetë dhe vdekje në Krishtlindje

Ndërsa isha gati të filloja këto devocione, dëgjova që Marion Newstram sapo kishte vdekur. Ajo dhe bashkëshorti i saj Elmer kanë qenë pjesë e kishës Baptiste Betlehem që para se shumica e anëtarëve tanë të kishte lindur. Marion ishte 87 vjeç. Ata qenë të martuar për 64 vjet.

Kur fola me Elmerin dhe i thashë se doja të ishte i fortë në Zotin dhe të mos ligështohet me jetën, ai më tha: “Ai ka qenë një mik i vërtetë.” Lutem që të gjithë të krishterët të kenë mundësi të thonë në fund të jetës së tyre: “Krishti ka qenë një mik i vërtetë.”

Çdo stinë Krishtlindjeje kujtoj përvjetorin e vdekjes së nënës time. Jeta iu ndërpre kur ishte 56 vjeç në një aksident me autobus në Izrael. Ishte 16 Dhjetor 1974. Edhe sot, ato ngjarje janë jashtëzakonisht reale për mua. Nëse e lëshoj veten, fare lehtë mund të përlohem—për shembull, kur mendoj që djemtë e mi nuk e njohën kurrë gjyshen e tyre. Varrimi i saj ishte një ditë pas Krishtlindjes. Oh, sa e çmuar ishte ajo Krishtlindje!

Shumë prej jush e ndieni humbjen tuaj këtë Krishtlindje më tepër se më parë. Mos i rezisto! Lëre të vijë. Ndieje! Përse shërben dashuria, nëse nuk është për të intensifikuar ndjenjat tona—si në jetë ashtu dhe vdekje? Por, oh, mos u hidhëro! Hidhërimi është vetëshkatërrim tragjik.

Jezusi erdhi në Krishtlindje, në mënyrë që të kemi jetën e përjetshme: “Unë kam ardhur që të kenë jetë e ta kenë me bollëk” (Gjoni 10:10). Elmer dhe Marion kishin biseduar ku do t’i kalonin vitet e tyre të fundit. Elmeri tha: “Unë dhe Marion ramë dakord që banesa jonë e fundit dhe e përjetshme do të jetë me Zotin.”

A ndihemi të përmalluar për shtëpinë? Me rastin e festave, më vijnë familjarë për vizitë. Kjo më bën të ndihem mirë. Mendoj se arsyeja themelore pse ndihemi mirë, është që unë dhe ata, në thellësi të qenies tonë, jemi të destinuar për një ribashkim përfundimtar. Të gjitha mbledhjet e tjera në shtëpi janë thjesht një shije e asaj që na pret. Si të tilla, janë të mira.

Por jo kur zëvendësojnë më të mirën! Mos lejo që gjërat e ëmbla të kësaj stine të zëvendësojnë ëmbëlsinë e madhe, përfundimtare dhe plotësisht të kënaqshme. Lejo që çdo humbje dhe çdo kënaqësi të ta përmallojë zemrën për qiellin.

Krishtlindja. Çfarë tjetër është ajo veçse: *Unë kam ardhur që të kenë jetë*. Që Marion Newstram, Ruth Piper, ti dhe unë—që ne të mund të kemi jetë, tani e përjetë.

Bëje të *tashmen* tënde më të pasur dhe më të thellë këtë Krishtlindje duke pirë nga burimi i *përjetësisë*. Përjetësia është shumë afër.





## Tërheqja më e suksesshme e Perëndisë

**K**rishtlindja shënoi fillimin e tërheqjes më të suksesshme të Perëndisë. Ai ka qenë gjithmonë i kënaqur ta tregojë pushtetin e Tij përmes gjërave që nga jashtë duken si dështime. Perëndia bën tërheqje taktike për të korrur fitore strategjike.

Në Dhiatën e Vjetër, njërit nga dymbëdhjetë bijtë e Jakobit, Jozefit, iu premtua në ëndërr lavdi dhe pushtet (Zanafilla 37:5-11). Për ta arritur atë fitore, iu desh të bëhej skllav në Egjipt. Sikur kjo të mos mjaftonte, kur gjendja e tij u përmirësua për shkak të integritetit të tij, Jozefi u bë më keq se një skllav. Ai ra në burg.

Gjithsesi, e gjitha kjo ishte planifikuar—ishte planifikuar nga Perëndia për të mirën e tij dhe të familjes së tij, dhe më në fund për të mirën e të gjithë botës! Arsyeja është që atje në burg ai takoi kupëmbajtësin e faraonit. Kupëmbajtësi e nxori para faraonit dhe ky i fundit e vendosi mbi gjithë Egjiptin. Më në fund, ëndrra e Jozefit u realizua. Vëllezërit

e tij u përkulën para tij dhe ai i shpëtoi nga uria. Sa rrugë e çuditshme drejt lavdisë!

Sidoqoftë, kjo është udha e Perëndisë—madje edhe për Birin e Tij. Ai e zbrazi veten dhe mori trajtë shërbëtori. Më keq se një skllav ai u burgos dhe u ekzekutua. Por njësoj si Jozefi, Ai e ruajti integritetin e tij: “Prandaj edhe Perëndia e lartësoi madhërisht dhe i dhuroi një emër përmbi çdo emër, që në emër të Jezusit të përkulet çdo gju” (Filipianëve 2:9-11).

Kjo është udha e Perëndisë edhe për ne. Neve na është premtuar lavdi—*nëse* vuajmë bashkë me Të, sikurse thuhet te Romakëve 8:17. Rruga për t’u ngjitur lart, shkon poshtë. Për të ecur përpara, duhet të shkojmë pas. Udha drejt suksesit është përmes pengesave të caktuara në mënyrë hyjnore. Ato gjithmonë do të duken si dështime dhe kështu do të ndihemi.

Nëse Jozefi dhe Jezusi po na mësojnë ndonjë gjë këtë Krishtlindje është kjo: “Perëndia ka dashur që t’i shërbejë së mirës...” (Zanafilla 50:20).

Shenjtorë të trembur, merrni guxim  
Retë nga të cilat keni kaq frikë  
Janë të ngarkuara plot me mëshirë  
Mbi ju do t’bien porsi bekim.<sup>1</sup>

1 William Cowper, “God Moves in a Mysterious Way,” 1773.







DITA 17

## Shpëtimi më i madh që mund të përfytyrojmë

**P**erëndia është i drejtë, i shenjtë dhe i veçuar nga mëkatarët si ne. Ky është problemi ynë kryesor në kohën e Krishtlindjes—dhe në çdo kohë tjetër. Si mund ta rregullojmë marrëdhënien me një Perëndi të drejtë dhe të shenjtë?

Prapëseprapë, Perëndia është i mëshirshëm dhe ka premtuar te Jeremia 31 (pesëqind vjet para Krishtit) që një ditë do të bënte diçka të re. Ai do t'i zëvendësonte hijet me realitetin e Mesias. Perëndia do të vepronte fuqishëm në jetën tonë dhe do ta shkruante vullnetin e Tij në zemrat tona, në mënyrë që të mos jemi të shtrënguar nga jashtë, por të vullnetshëm nga brenda për ta dashur Atë, për t'i besuar dhe për ta ndjekur.

Ky do të ishte shpëtimi më i madh që mund të përfytyronim—nëse Perëndia do të na ofronte realitetin më të madh në univers për ta shijuar dhe pastaj të vepronte brenda nesh për t'u siguruar që ne do ta shijonim këtë shpëtim

me gëzimin dhe lirinë më të madhe të mundshme. Kjo do të ishte një dhuratë Krishtlindjeje, për të cilën do t'ia vlente të këndonim.

Në fakt, kjo është ajo që Ai premtoi në besëlidhjen e re, por kishte një pengesë të madhe: mëkati ynë. Ndarja nga Perëndia për shkak të padrejtësisë tonë.

Si mundet një Perëndi i shenjtë dhe i drejtë të na trajtojë ne mëkatarët me aq shumë mirësi sa të na japë realitetin më të madh në gjithësi (Birin e Tij) që të kënaqemi me Të, me gëzimin më të madh të mundshëm?

Përgjigjja është se Perëndia i vendosi mëkatet tona mbi Birin e Tij dhe atje i gjykoi, që të mund t'i largonte prej mendjes së Tij dhe të na trajtonte mëshirshëm, e në të njëjtën kohë të mbetej i drejtë dhe i shenjtë. Hebrejve 9:28 thotë: "... kështu edhe Krishti, pasi u dha një herë për të marrë mbi vete mëkatet e shumë njerëzve." (versioni "Së Bashku")

Krishti mbarti mëkatet tona në trupin e Tij kur vdiq (1 e Pjetrit 2:24). Ai mori gjykimin tonë (Romakëve 8:3). Ai e shfuqizoi fajin tonë (Romakëve 8:1). Kjo do të thotë se mëkatet tona janë hequr (Veprat 10:43). Ato nuk janë në mendjen e Perëndisë si një shkak për të na dënuar. Në atë kuptim, Ai i "harron" mëkatet tona (Jeremia 31:34). Ato janë konsumuar në vdekjen e Krishtit.

Kjo do të thotë se tani Perëndia është i lirë në drejtësinë e Tij, për të na bekuar bujarisht me bekimet e patregueshme të besëlidhjes së re. Ai na jep Krishtin, realitetin më të madh në gjithësi, që ne ta shijojmë. Ai e shkruan vullnetin

DITA 17

e Tij–zemrën e Tij–në zemrat tona, në mënyrë që ta duam,  
t’i besojmë dhe ta ndjekim Krishtin nga brendësia e qenies  
tonë, me liri dhe gëzim.







## Modeli i Krishtlindjes për misionin

**K**rishtlindja është një model për misionin. Misioni është një pasqyrë e Krishtlindjes: “Si unë, ashtu edhe ju.”

Për shembull, rreziku. Krishti erdhi te të vetët dhe ata nuk e pranuan, kështu do të ndodhë edhe me ju. Ata komplotuan kundër Tij. Kështu edhe me ju. Ai nuk kishte një shtëpi. Kështu edhe me ju. Ata ngritën akuza të rreme kundër Tij. Kështu do të ndodhë edhe me ju. Ata e fshikulluan dhe e tallën. Kështu edhe me ju. Ai vdiq pas tre viteve shërbesë. Kështu edhe me ju.

Por ka një rrezik më të keq se këto, të cilit Jezusi i *shpëtoi*. Kështu duhet të ndodhë edhe me ju!

Në mes të shekullit të gjashtëmbëdhjetë, Francis Havier (1506-1552), një misionar katolik i shkroi Atë Perezit të Malakës (sot është pjesë e Malajzisë) për rreziqet e misionit të tij në Kinë. Ai i tha: “Rreziku më i madh nga të gjithë do të ishte të humbja besimin dhe sigurinë në mëshirën e Perëndisë... Të mos i besojmë Atij, do të ishte shumë herë

më e tmerrshme se çdo ligësi fizike, që mund të na bëjnë gjithë armiqtë e Perëndisë të marrë së bashku, sepse pa lejen e Perëndisë as djajtë dhe as pushtetet njerëzore s'mund të na pengojnë qoftë dhe një thërrime.”<sup>1</sup>

Rreziku më i madh me të cilin përballet një misionar nuk është vdekja, por është të mos i besojë mëshirës së Perëndisë. Nëse ky rrezik mënjanohet, atëherë të gjitha rreziqet e tjera e humbasin forcën e tyre.

Në fund, Perëndia e kthen çdo shpatë në një skeptër në duart tona. Ashtu si thotë dhe J. W. Alexander: “Çdo çast i mundimeve të tanishme do të shpaguhet hirshëm me një milionë epoka lavdie.”<sup>2</sup>

Krishti i shpëtoi këtij rreziku–rrezikut të mosbesimit të Perëndisë. Prandaj Perëndia e lartësoi jashtëzakonisht. Si me Atë, ashtu do të ndodhë edhe me ju.

Në këtë stinë Adventi mbani mend që Krishtlindja është një model për misionin. *Si unë, ashtu edhe ju*. Mision do të thotë rrezik dhe rreziku më i madh është të mos i besoni mëshirës së Perëndisë. Nëse dorëzoheni para kësaj, humbisni gjithçka. Ngadhënjeni mbi të dhe asgjë s'mund t'ju lëndojë për një milion epoka.

1 Nga “A Letter to Father Perez,” në *Classics of Christian Missions*, redaktuar nga Francis M. DuBose (Nashville, TN: Broadman Press, 1979), 221f.

2 J. W. Alexander, *Thoughts on Preaching: Classic Contributions to Homiletics* (Edinburgh: Banner of Truth, 1975), 108.







## Krishtlindja ka të bëjë me lirinë

Jezusi u bë njeri, për shkak se ajo që nevojitej ishte vdekja e një njeriu, që ishte më tepër se njeri. Mishërimi ishte mënyra se si Perëndia e vendosi veten nën dënimin me vdekje.

Krishti nuk rrezikoi vdekjen, Ai e zgjodhi vdekjen, e përqafoi atë. Kjo ishte pikërisht arsyeja pse Ai erdhi: “jo që t’i shërbejnë por për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e tij si shpërblësë për shpengimin e shumë vetave” (Marku 10:45).

Nuk është çudi që satani u përpoq ta largonte Jezusin prej kryqit—përmes tundimit në shkretëtirë (Mateu 4:1-11) dhe përmes fjalëve të Pjetrit (Mateu 16:21-23)! Kryqi ishte shkatërrimi i satanit. Si e shkatërroi Jezusi atë?

Hebrenjve 2:14 thotë se satani ka “pushtetin e vdekjes”. Kjo do të thotë se satani ka aftësinë për ta bërë vdekjen të frikshme. “Pushteti i vdekjes” është pushteti që i mban njerëzit në skllavëri përmes frikës së vdekjes. Është pushteti për t’i mbajtur njerëzit në mëkat, në mënyrë që vdekja të vijë si një gjë e tmerrshme.

Por Jezusi e zhveshi satanin nga ky lloj pushteti. Ai e çarmatosi satanin dhe farkëtoi një parzmore drejtësie për ne, e cila na mbron nga dënimi e djallit. Si e bëri Jezusi këtë?

Përmes vdekjes së Tij, Jezusi i hoqi tej gjithë mëkatet tona. Një person pa mëkat nuk mund të dënohet nga satani. Duke qenë se jemi të falur, ne jemi përfundimisht të pashkatërrueshëm. Plani i satanit ishte që ta shkatërronte sundimin e Perëndisë duke i dënuar ndjekësit e Tij në vetë gjykatën e Perëndisë. Tradhtia e satanit është ndërprerë dhe dinakëria e tij kozmike është thyer. Ne “mund ta durojmë tërbimin e tij, se ditët i ka të numëruara.”<sup>1</sup> Kryqi i ka kaluar tejprtej dhe shumë shpejt do të japë frymën e fundit.

Krishtlindja ka të bëjë me lirinë–liri nga frika e vdekjes.

Jezusi mori natyrën tonë në Betlehem, për të vdekur në vendin tonë në Jerusalem—që sot ne të jemi sypatrembur në qytetin tonë. Po, sypatrembur, sepse nëse kërcënimimi më i madh ndaj gëzimit tonë është hequr, atëherë pse të shqetësohemi për rreziqet e vogla? Si mund të themi (me të vërtetë): “Nuk kam frikë të vdes, por kam frikë se humbas punën”? Jo, jo. Mendo pak!

Nëse vdekja (thashë vdekja—të mos kesh puls, të jesh i ftohtë, të kesh ikur!)—nëse vdekja nuk është më frikë, ne jemi të lirë, vërtet të lirë. Jemi të lirë të ndërmarrim çdo rrezik nën diell për Krishtin dhe për dashurinë. Nuk jemi më skllëvër të ankthit.

Nëse Biri të ka çliruar, atëherë do të jesh me të vërtetë i lirë!

1 Martin Luther, “*A Mighty Fortress Is Our God*,” 1527–1529.





DITA 20

## Solidariteti i Krishtlindjes

**P**unishtja e satanit nxjerr miliona mëkate çdo ditë. Ai i ngarkon ato në avionë të mëdhenj mallrash, i çon në qiell, i hap para Perëndisë dhe shkrihet së qeshuri.

Disa njerëz punojnë me kohë të plotë në punishten e satanit, të tjerë e kanë lënë punën atje dhe kthehen rrallë.

Çdo minutë që punohet në punishten e mëkatit, e bën Perëndinë arsyen e të qeshurave të satanit. Mëkati është puna e satanit, për shkak se ai e urren dritën, bukurinë, pastërtinë dhe lavdinë e Perëndisë. Asgjë nuk i pëlqen më tepër se çasti kur krijesat nuk i besojnë dhe nuk i binden Krijuesit të tyre.

Prandaj, Krishtlindja është lajm i mirë për njeriun dhe për Perëndinë.

“Kjo fjalë është e besueshme dhe e denjë për t’u pranuar plotësisht, që Krishti Jezus erdhi në botë për të shpëtuar mëkatarët, ndër të cilët unë jam i pari” (1 e Timoteut 1:15). Ky është lajm i mirë për ne.

“Për këtë është shfaqur Biri i Perëndisë: për të shkatë-

rruar veprat e djallit” (1 e Gjonit 3:8). Ky është gjithashtu lajm i mirë për Perëndinë.

Krishtlindja është lajm i mirë për Perëndinë, për shkak se Jezusi erdhi të niste një grevë në punishten e satanit. Ai shkoi në mes të fabrikës, i bëri thirrje solidaritetit të besnikëve dhe filloi një braktisje masive nga punishtja.

Krishtlindja është një thirrje për grevë në punishten e mëkatit. Nuk ka negociata me administratën, nuk ka pazarllëqe, thjesht kundërshtim të pathyeshëm ndaj produktit. Nuk do të jemi më pjesë e prodhimit të mëkatit.

Solidariteti i Krishtlindjes ka për qëllim t’i ulë avionët e mallrave. Nuk do të përdorë dhunë apo forcë, por me një përkushtim të paepur ndaj së vërtetës do të demaskojë kushtet jetëshkatërruese të industrisë së djallit.

Solidariteti i Krishtlindjes nuk do të dorëzohet, derisa të arrihet një mbyllje përfundimtare e punishtes.

Kur mëkati të jetë shkatërruar, emri i Perëndisë do të shfaqësohet plotësisht. Askush nuk do të qeshë më me Të.

Nëse dëshiron që këtë Krishtlindje t’i japësh një dhuratë Perëndisë, dil nga punishtja e mëkatit dhe mos u kthe më kurrë. Zër vendin tënd në vijën e dashurisë. Bashkoju solidaritetit të Krishtlindjes, derisa emri i madhërisëm i Perëndisë të lartësohet dhe Ai të qëndrojë i lavdishëm mes lavdërimeve të të drejtëve.







## DITA 2 I

# Lindja e të Lashtit të ditëve

**G**joni 18:37 është një tekst shumë i mirë për Krishtlindje, edhe pse vjen nga fundi i jetës tokësore të Jezusit dhe jo nga fillimi i saj.

Vërejmë që Jezusi nuk po thotë vetëm se Ai lindi, por që Ai “ka ardhur në botë”. Veçantia e lindjes së Tij është se Ai nuk filloi të ekzistonte atë ditë, por Ai ekzistonte para se të lindte në grazhd. Personi, karakteri, personaliteti i Jezusit të Nazaretit ekzistonin para se njeriu Jezus i Nazaretit të lindte.

Fjala teologjike për ta përshkruar këtë mister nuk është *krijim*, por *mishërim*. Personi, jo trupi, por qenia thelbësore e Jezusit, ekzistonte para se Ai të lindte si njeri. Lindja e Tij nuk ishte ardhja në ekzistencë e një personi të ri, por ardhja në botë e një personi pafundësisht të lashtë.

Mikea 5:2 e thotë kështu shtatëqind vjet para se Jezusi të lindte:

Por ti, o Bethlem Efratah,  
 megjithëse je i vogël midis mijërave të Judës,  
 nga ti do të dalë për mua  
 ai që do të jetë sundues në Izrael,  
 origjinat e të cilit janë nga kohërat e lashta,  
 nga ditët e përjetësisë.

Misteri i lindjes së Jezusit nuk është thjesht se lindi prej një virgjëreshe. Ajo mrekulli u caktua prej Perëndisë që të dëshmonte për një mrekulli edhe më të madhe—domethënë që fëmija i lindur në Krishtlindje ishte një person që ekzistonte “nga kohërat e lashta, nga ditët e përjetësisë”.

Lindja e Tij, pra, ishte e qëllimshme. Që para se të lindte, Ai mendoi për lindjen e Tij. Bashkë me Atin e Tij, Ai pati një plan. Pjesë e atij plani të madh ishte edhe ajo që tha në orët e Tij të fundit mbi këtë tokë: “Për këtë unë kam lindur dhe për këtë kam ardhur në botë; që të dëshmoj për të vërtetën; kushdo që është prej së vërtetës, dëgjon zërin tim” (Gjoni 18:37).

Jezusi ishte e vërteta e përjetshme. Ai foli vetëm të vërtetën. Jezusi mishëroi të vërtetën më të madhe të dashurisë. Ai po mbledh në familjen e Tij të përjetshme të gjithë ata që kanë lindur nga e vërteta. Ky ishte plani që nga ditët e lashta.





## Që ju të besoni

**E**ndiej shumë të nevojshme të them se mes nesh që jemi Erritur në kishë, që mund t'i recitojmë doktrinat e mëdha të besimit tonë në gjumë e përsëri na hapet goja kur themi Kredon e Apostujve—duhet bërë diçka që të na ndihmojë të ndiejmë edhe një herë mahnitjen, frikën, habinë dhe mrekullinë e Birit të Perëndisë, të lindurit prej Atit që nga përjetësia, atij që reflekton gjithë lavdinë e Perëndisë, që është vetë imazhi i personit të Tij, përmes të të cilit u krijuan të gjitha gjërat dhe që vazhdon ta mbajë gjithësinë përmes fjalës së fuqisë së Tij.

Mund të lexosh çdo përrallë të shkruar ndonjëherë, çdo roman fantastiko-shkencor, çdo histori me fantazma dhe nuk ke për të gjetur ndonjë gjë aq tronditëse, aq të çuditshme dhe aq magjepsëse sa historia e mishërimit të Birit të Perëndisë.

Sa të vdekur që jemi! O Perëndi, sa të mpirë dhe të pandjeshëm jemi ndaj lavdisë së kësaj historie! Sa shpesh më është dashur të pendohem dhe të them: “Perëndi, më vjen keq që historitë e krijuara nga njeriu më prekin emocionet,

habinë dhe mahnitjen time, admirimin dhe gëzimin, më tepër se historia jote.”

Ndoshta filmat triller të galaktikës mund të na bëjnë të paktën këtë të mirë: ato mund të na përulim dhe të na sjellin në pendim. Gjithashtu na tregojnë se në fakt jemi të aftë të përjetojmë një pjesë të mahnitjes, habitës dhe mrekullisë, që rrallë i ndiejmë kur meditojmë për Perëndinë e përjetshëm, për lavdinë kozmike të Krishtit dhe për një kontakt të vërtetë e të gjallë mes nesh dhe Perëndisë, të cilën e gjejmë në Jezusin e Nazaretit.

Kur Jezusi tha: “për këtë kam ardhur në botë” (Gjoni 18:37), Ai tha diçka të çmendur, të çuditshme dhe të frikshme, si deklaratat që mund të kesh lexuar në letërsinë fantastiko-shkencore.

Oh, sa po lutem për një derdhje të Frymës së Perëndisë mbi ty dhe mua, që Fryma e Shenjtë të zbresë frikshëm në përjetimin tim, që të më zgjojë përballë realitetit të papërfytyrueshëm të Perëndisë!

Një ditë, vetëtimia do ta çajë qiellin nga lindja e diellit deri në perëndim, dhe mbi retë do të shfaqet Biri i Njeriut bashkë me engjëjt e Tij të pushtetshëm me një zjarr flakërues. Ne do ta shohim qartë Atë. Qoftë nga terrori apo thjesht nga ngazëllimi, ne do të dridhemi dhe do të vrasim mendjen se si kemi jetuar aq gjatë me një Krisht të zbutur dhe të parrezikshëm.

Këto gjëra janë shkruar—e gjithë Bibla është shkruar—që ne të besojmë, që të shtangemi, të zgjohemi dhe të mahnitemi, që Jezu Krishti është Biri i Perëndisë, që erdhi në botë.







DITA 23

## Dhurata e papërshkrueshme e Perëndisë

**P**raktikisht, si e marrim pajtimin dhe si mburremi në Perëndinë? Përmes Jezu Krishtit. Kjo do të thotë se e bëjmë portretin e Jezusit në Bibël, pra: veprën dhe fjalët e Jezusit të portretizuara në Dhiatën e Re, përmbajtjen thelbësore të mburrjes tonë në Perëndinë. Pa përmbajtjen e Krishtit, mburrja në Perëndinë nuk e nderon Krishtin. Dhe atje ku Krishti nuk nderohet, nuk nderohet Perëndia.

Te 2 e Korintasve 4:4-6, Pali e përshkruan kthimin në besim në dy mënyra. Në vargun 4, ai thotë se kthimi në besim është të shohësh “lavdinë e Krishtit, që është shëmbëllimi i Perëndisë”. Dhe në vargun 6, ai thotë se është shikimi i “lavdisë së Perëndisë, në fytyrën e Jezu Krishtit”. Në të dyja rastet e dallojmë idenë. Kemi Krishtin, shëmbëllimin e Perëndisë dhe kemi Perëndinë, në fytyrën e Krishtit.

Të mburremi në Perëndinë do të thotë të mburremi në atë që shohim dhe dimë për Perëndinë në portretin e Jezu Krishtit. Kjo mburrje arrin përjetimin e saj të plotë

kur dashuria e Perëndisë derdhet në zemrën tonë përmes Frymës së Shenjtë, ashtu si na thotë Romakëve 5:5. Ai përjetim i ëmbël i dashurisë së Perëndisë, i dhënë nga Fryma, na përcillet gjatë meditimit tonë mbi realitetin historik të vargut 6: “Sepse, ndërsa ishim ende të dobët, Krishti vdiq në kohën e tij për të pabesët.”

Ja, pra, theksi i Krishtlindjes. Jo vetëm që Perëndia bleu pajtimin tonë me anë të vdekjes së Zotit Jezu Krisht (Romakëve 5:10), jo vetëm që na aftësoi ta pranonim pajtimin përmes Zotit Jezu Krisht, por që tani ne mburremi në vetë Perëndinë nëpërmjet Frymës, përmes Zotit tonë Jezu Krisht (Romakëve 5:11).

*Jezusi bleu pajtimin tonë.* Ai na aftësoi që të marrim pajtimin dhe të hapim dhuratën. Vetë Jezusi shkëlqen si dhurata e papërshkrueshme e Perëndisë–Perëndia në mish–duke nxitur gjithë mburrjen tonë në Perëndinë.

Shiko drejt Jezusit këtë Krishtlindje. Pranoje pajtimin që Ai e bleu. Mos e lër të pahapur dhuratën në raft. Edhe kur ta hapësh, kujto që vetë Perëndia është dhurata e pajtimit me Perëndinë.

Mburru në Të! Përjetoje Atë si kënaqësinë tënde. Njihe Perëndinë si thesarin tënd.





## Dy qëllimet për Krishtlindje

**K**ur 1 e Gjonit 3:8 thotë: “Prandaj është shfaqur Biri i Perëndisë: për të shkatërruar veprat e djallit,” cilat janë “veprat e djallit” për të cilat flet Gjoni? Përgjigjja është e qartë nga konteksti.

Së pari, 1 e Gjonit 3:5 është një paralele e qartë: “Dhe ju e dini se ai u shfaq për të hequr mëkatet tona.” Faza “ai u shfaq për të” përdoret në vargjet 5 dhe 8. Prandaj gjasat janë që “veprat e djallit”, të cilat Jezusi erdhi t’i shkatërronte, janë mëkatet. Pjesa e parë e vargut 8 e bën shumë të qartë: “Kush bën *mëkat* është nga djalli; sepse djalli mëkaton nga fillimi.”

Çështja në këtë kontekst është *të mëkatuarit*, nuk janë sëmundjet, makina e prishur apo oraret e ngatërruara. Jezusi erdhi në botë për të na ndihmuar të ndalojmë së mëkatuari.

E shohim akoma më qartë, nëse këtë të vërtetë e vendosim krah për krah me 1 e Gjonit 2:1: “Djema të mi, ju shkruaj këto *që të mos mëkatoni*.” Ky është një nga qëllimet

më të mëdha të Krishtlindjes, një nga qëllimet më të mëdha të mishërimit (1 e Gjonit 3:8).

Por ka edhe një qëllim tjetër pse Gjoni shton te 1 e Gjonit 2:1-2: “Dhe në qoftë se ndokush ka mëkatuar, kemi një avokat tek Ati, Jezu Krishtin, të drejtin. Ai është shlyesi për mëkatet tona; dhe jo vetëm për tonat, por edhe për *ato* të të gjithë botës.”

Shiko kuptimin e kësaj: Jezusi u shfaq në botë për dy arsye. Ai erdhi që ne të mos vazhdojmë të mëkatojmë—pra, Jezusi erdhi të shkatërronte veprat e djallit (1 e Gjonit 3:8); dhe Ai erdhi që të siguronte shlyerjen për mëkatet tona, nëse mëkatojmë. Ai erdhi që të ishte një flijim zëvendësues, që heq tej zemërimin e Perëndisë për mëkatet tona.

Rezultati i këtij qëllimi të dytë nuk është që të dobësojë qëllimin e parë. Falja nuk ka qëllim lejimin e mëkatit. Vdekja e Krishtit për mëkatet tona nuk synon që ne të rehatohemi në betejën tonë kundër mëkatit. Përkundrazi, rezultati i këtyre dy qëllimeve të Krishtlindjes është që pagesa e kryer njëherë e përgjithmonë për mëkatet tona, të jetë për ne liria dhe pushteti që na aftësojnë ta luftojmë mëkatin, jo si legalistë, duke u përpjekur të fitojmë shpëtimin tonë, as si të frikësuar se mos e humbim atë, por si fitimtarë që hidhen në betejë kundër mëkatit me gëzim dhe siguri, edhe nëse kjo na kushton jetën.







DITA 25

## Tri dhurata për Krishtlindje

**L**e të mendojmë pak bashkë mbi këtë situatë të jashtëzakonshme. Nëse Biri i Perëndisë erdhi të të ndihmojë që të ndalosh së mëkatuari—pra, për të shkatërruar veprat e djallit—nëse Ai gjithashtu erdhi të vdiste, që kur ti të mëkatosh, të ketë një shlyerje dhe zemërimi i Perëndisë të hiqet, atëherë çfarë thotë kjo për mënyrën si duhet ta jetosh jetën?

Tri gjëra. Dhe këto janë të mrekullueshme për t'i pasur. Po i jap shkurtimisht si dhurata për Krishtlindje:

### *Dhurata 1: Një qëllim i qartë për jetën*

Rrjedhoja e parë nënkupton që ke një qëllim të qartë për jetën. Mohore është kështu: mos mëkato—mos bëj atë që e çnderon Perëndinë: “Djema të mi, ju shkruaj këto që të mos mëkatoni” (1 e Gjonit 2:1); “Prandaj është shfaqur Biri i Perëndisë: për të shkatërruar veprat e djallit” (1 e Gjonit 3:8).

Nëse po pyet: “A mund të na e thuash pohore dhe jo mohore këtë?”, përgjigjja është: “Po, gjithçka përmbledhet tek 1 e Gjonit 3:23.” Kjo është një përmbledhje fantastike

për atë që kërkon gjithë letra e Gjonit. Vëzhgo “urdhërimin” në njëjës: “Dhe ky është *urdhërimi* i tij që të besojmë në emrin e Birit të Perëndisë, Jezu Krisht dhe ta duam njëri-tjetrin si na dha urdhërim.” Këto dy gjëra janë të lidhura shumë ngushtë në mendjen e Gjonit, pasi ai i quan një urdhërim të vetëm: beso në Jezusin dhe duaji të tjerët. Ky është qëllimi yt. Kjo është tërësia e jetës së krishterë. T’i besosh Jezusit, të duash njerëzit ashtu si Jezusi dhe apostujt e tij na mësuam t’i duam. Besoji Jezusit, duaji njerëzit! Kjo është dhurata e parë: një qëllim për jetën.

*Dhurata 2: Shpresë se dështimet tona do të falen*

Rrjedhoja e dytë e të vërtetës së dyfishtë që Krishti erdhi jo vetëm që t’i shkatërronte mëkatet tona, por dhe t’i falte ato, është kjo: ne përparojmë në mposhtjen e mëkatit tonë kur kemi shpresë se dështimet tona do të falen. Nëse s’ke shpresë se Perëndia do të t’i falë dështimet, sapo nis të luftosh mëkatit, dorëzohesh.

Shumë prej jush po mendoni për disa ndryshime këtë vit që vjen, për shkak se keni zakone të mëkatshme dhe dëshironi të dilni prej tyre. Dëshironi modele të reja ushqyerje, modele të reja për argëtimin, modele të reja për dhënien. Modele të reja për marrëdhënien me bashkëshorten, modele të reja për devocionin familjar, modele të reja gjumi dhe ushtrimesh fizike. Modele të reja guximi për të dëshmuar. Por gjithsesi po përleshesh, duke vrrarë mendjen, nëse ia vlen. Ja, pra, ku është dhurata e dytë për Krishtlindje: Krishti jo vetëm që erdhi të shkatërronte veprat e djallit—të

mëkatuarit tonë—por Ai gjithashtu erdhi për të qenë avokati ynë kur dështojmë në luftën tonë.

Prandaj të përgjërohëm, lejo këtë të vërtetë të të japë shpresë për të luftuar: dështimi nuk e ka fjalën e fundit. Por, kujdes! Nëse e kthen hirin e Perëndisë në liri për të mëkatuar dhe thua: “E po, nëse dështokam dhe s’ka rëndësi, atëherë pse ta vras mendjen për të luftuar kundër mëkatit?”—nëse mendon kështu dhe e ke me tërë mend, nëse vazhdon të veprosht në këtë mënyrë, ka të ngjarë që nuk ke lindur sërish dhe për këtë duhet të dridhesh.

Gjithsesi, shumica prej jush nuk janë në këtë pozitë. Shumica prej jush dëshironi t’i luftoni modelet mëkatore në jetët tuaja. Ajo që Perëndia po ju thotë është kjo: Lejojeni faktin që Krishti i mbulon dështimet tuaja, t’ju japë shpresë për të luftuar. “Ju shkruaj këto që të mos mëkatoni; dhe në qoftë se ndokush ka mëkatuar, kemi një avokat tek Ati, Jezu Krishtin.”

### *Dhurata 3. Krishti do të na ndihmojë*

Përfundimisht, rrjedhoja e tretë e të vërtetës së dyfishtë që Krishti erdhi të shkatërronte mëkatet tona dhe të na falte mëkatet, është kjo: Krishti do të na *ndihmojë* me të vërtetë në luftën tonë. Ai do të të ndihmojë me të vërtetë! Ai është në anën tënde. Krishti nuk erdhi ta shkatërronte mëkatin, për shkak se mëkati është argëtues, por sepse ai është fatal. Mëkati është puna mashtruese e djallit, dhe ai do të na shkatërrojë, nëse nuk e luftojmë, por Krishti erdhi për të na ndihmuar, jo për të na lënduar.

Ja dhe dhurata jote e tretë për Krishtlindje: Krishti do të të ndihmojë ta mposhtësh mëkatin në ty. 1 e Gjonit 4:4 thotë: “Ai në ju është më i madh se ai në botë.” Jezusi është i gjallë, Jezusi është i gjithëpushtetshëm, Ai jeton në ne me anë të besimit. Jezusi është për ne dhe jo kundër nesh. Ai do të të ndihmojë në luftën tënde. Besoji Atij!







## PËRFUNDIM

# Teksti im i parapëlqyer i Krishtlindjes

**T**eksti im i parapëlqyer i Krishtlindjes e vendos përlësinë mu në zemër të Krishtlindjes. Prandaj këtë Krishtlindje po mrekullohem me përlësinë e Jezusit dhe dëshiroj më tepër prej kësaj përlësie në jetën time. Pas pak do të citoj vargjet.

Së pari, ka dy probleme. Tim Keller na ndihmon ta shohim njërin prej tyre kur thotë: “Përlësia ka shumë turp. Nëse nis e flet për të, ajo largohet.” Prandaj një meditim (si ky) rreth përlësisë duket si pa vend, por edhe njerëzit e turpshëm vështrojnë ndonjëherë, nëse po trajtohen mirë.

Problemi tjetër është se Jezusi nuk ishte i përlurur për të njëjtat arsye që jemi ne (apo që duhet të jemi). Prandaj, si na ndihmon *ne* të soditurit e përlësisë së Jezusit në Krishtlindje? Nëse kemi ndonjë fije përlësie, ajo është e bazuar në kufizimin dhe gabueshmërinë tonë, si dhe në të qenët mëkatarë. Por Biri i përjetshëm i Perëndisë nuk ishte i fundmë. Ai ishte i pagabueshëm dhe aspak mëkatar.

Kështu që, ndryshe nga përlësia jonë, përlësia e Jezusit buronte nga diçka tjetër.

Ja cili është teksti im i parapëlqyer për Krishtlindje. Shiko për përlësinë e Jezusit:

I cili, edhe pse ishte në trajtë Perëndie, nuk e çmoi si një gjë ku të mbahej fort për të qenë barabar me Perëndinë, por e zbrazti veten e tij, duke marrë trajtë shërbëtori, e u bë i ngjashëm me njerëzit; dhe duke u gjetur nga pamja e jashtme posi njeri, *e përluli* veten duke u bërë i bindur deri në vdekje, edhe deri në vdekje të kryqit. (Filipianëve 2:6-8)

Përlësia e Jezusit karakterizohet kryesisht nga një veprim i ndërgjegjshëm për ta vendosur veten e Tij në rolin e një shërbëtori të përlur, për të mirën e të tjerëve. Përlësia e Tij përkufizohet nga fraza si:

“Ai e zbrazti veten [nga të drejtat e Tij hyjnore për të qenë i lirë nga abuzimi dhe vuajtja].”

“Ai mori trajtë shërbëtori.”

“Ai u bë i bindur deri në vdekje, edhe deri në vdekje të kryqit.”

Ja pse përlësia e Jezusit nuk tregon qëndrimin e një zemre që është e fundme, e gabueshme apo mëkatore. Zemra e Tij ishte një zemër me përsosmëri të pafund, vërtetësi të pagabueshme dhe liri nga çdo mëkat, dhe për këtë arsye

nuk kishte nevojë që t'i shërbenin. Ai ishte i lirë dhe i tejmbushur për të shërbyer.

Një tekst tjetër Krishtlindjeje, i cili thotë të njëjtën gjë, është Marku 10:45: “Sepse edhe Biri i njeriut *nuk erdhi që t'i shërbejnë*, por *për të shërbyer* dhe për të dhënë jetën e tij si shpërblesë për shpengimin e shumë vetave.” Përlësia e Jezusit nuk vinte nga ndjesia e një të mete në vetvete, por nga ndjesia e plotësisë në veten e Tij, të cilën Jezusi e vuri në dispozicion të të tjerëve për të mirën e tyre. Kjo ishte një përlulje vullnetare e vetes nga ana e Jezusit, që ta bënte lartësinë e lavdisë së Tij të disponueshme për t'u shijuar nga mëkatarët.

Jezusi lidh përlësinë e Tij në Krishtlindje dhe lajmin e mirë për ne kur thotë: “Ejani tek unë, o të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t'ju çlodh. Merrni mbi vete zgjedhën time dhe mësoni nga unë, sepse jam zemërbutë dhe *i përlulur nga zemra*; dhe do të gjeni prehje për shpirtrat tuaj. Sepse zgjedha ime është e butë dhe barra ime është e lehtë” (Mateu 11:28-30).

Përlësia e Jezusit na çliron nga barrët tona. Po të mos ishte i përlulur, Ai s'do të kishte qenë as “i bindur deri në vdekje, edhe deri në vdekje të kryqit”. Po të mos ishte i bindur për të vdekur për ne, do të ishim shtypur nën peshën e mëkateve tona. Jezusi e përluli veten për të marrë dënimin tonë (Romakëve 8:3).

Tani kemi arsye më të fortë për të qenë më të përlulur se më parë. Ne jemi të fundmë, të gabueshëm dhe mëkatarë, prandaj nuk kemi fare arsye për t'u mburrur, por tani sho-

him edhe gjëra të tjera përlëse: Shpëtimi ynë nuk i atribuohet punës tonë, por hirit të Perëndisë. Për këtë arsye, mburrja përjashtohet (Efesianëve 2:8-9). Mënyra si Jezusi e realizoi atë shpëtim të hirshëm ishte përmes përljes vullnetare dhe të ndërgjegjshme të vetvetes, përmes bindjes prej shërbëtori deri në pikën e vdekjes.

Si rrjedhim, përveç të qenët të fundmë, të gabueshëm dhe mëkatarë, tani kemi edhe dy impulse të tjera, që na ndihmojnë të përulemi: hiri falas dhe i pamërituar, mbi të cilin qëndrojnë të gjitha bekimet tona, si dhe një model shërbimi vetëmohues dhe sakrifkues, që vullnetarisht merr trajtë shërbëtori.

Ja pse jemi thirrur t'i bashkohemi Jezusit, që me ndërgjegje të përlim veten dhe të jemi shërbëtorë. “Por kush do të lartësojë veten, do të ulet; dhe kush do të përlë veten, do të lartësohet” (Mateu 23:12). “Kini në veten tuaj po atë mendje që ishte edhe në Jezu Krishtin...” (Filipianëve 2:5).

Le të lutemi që ky “virtut i druajtur”—ky themel masiv i shpëtimit dhe i shërbimit tonë—të dalë nga vendi i tij i qetë dhe të na veshë me petkat e përlësisë në këtë Advent. “Vishuni me përlje, sepse Perëndia i kundërshton mendjemëdhenjtë, por u jep hir të përlurve” (1 e Pjetrit 5:5).





SHTOJCË

## Hijet e Dhiatës së Vjetër dhe ardhja e Krishtit!

Një nga pikat kryesore të librit të Hebrenjve është që sistemi i adhurimit të besëlidhjes së vjetër është një hije e zëvendësuar prej Krishtit. Andaj, Krishtlindja është zëvendësimi i hijeve me realitetin. (Këtë mund ta shohësh te Hebrenjve 8:5, ku thuhet se priftërinjtë “shërbejnë *sipas shembullit dhe hijes së gjërave qiellore.*”) Le të marrim në konsideratë gjashtë hije të tilla, të cilat ardhja e Krishtit i zëvendëson me realitetin.

1. *Hija e priftërisë së besëlidhjes së vjetër.*

“Dhe ata qenë bërë priftërinj në numër të madh, sepse vdekja nuk i linte të mbeteshin përgjithnjë, kurse ai, mbasi mbetet përjetë, ka *priftëri të patjetërsueshme.*” (Hebrenjve 7:23-24)

2. *Hija e sakrificës së Pashkës.*

“Fshijeni, pra, majanë e vjetër, që të jeni një brumë i

ri, siç jeni pa maja; sepse *pashka jonë, që është Krishti*, u flijua për ne.” (1 e Korintasve 5:7)

### 3. *Hija e tabernakullit dhe e tempullit.*

“Dhe kryesorja e atyre gjërave, që po themi, është kjo: ne kemi një kryepriфт të tillë, i cili u ul në të djathtë të fronit të Madhërisë në qiej, shërbenjës i shenjtërores dhe i *tabernakullit të vërtetë*, të cilin e ngriti Zoti e jo njeriu.” (Hebrenjve 8:1-2)

“Jezusi u përgjigj dhe u tha atyre: ‘Prisheni këtë tempull dhe për tri ditë do ta ngre!’ Atëherë judenjtë thanë: ‘U deshën dyzet e gjashtë vjet që të ndërtohet ky tempull, dhe ti do ta ngrësh për tri ditë?’ Por ai foli për *tempullin e trupit të vet*.” (Gjoni 2:19-21)

### 4. *Hija e rrethprerjes*

“*Rrethprerja nuk është asgjë* dhe parrethprerja nuk është asgjë, por zbatimi i urdhërimeve të Perëndisë.” (1 e Korintasve 7:19)

### 5. *Hija e ligjeve të dietës*

“Ai u tha atyre: ‘As ju nuk e keni kuptuar? A nuk e kuptoni se njeriun nuk mund ta ndotë çfarë hyn tek ai nga jashtë, sepse nuk hyn në zemër, por në bark e pastaj jashtëqitet?’ Kështu Jezui i shpalli të pastra të gjitha ushqimet.” (Marku 7:18-19, Së Bashku)



*6. Hija e ditëve të festave*

“Prandaj askush të mos ju gjykojë për ushqime ose pije, për festa o hënë të re, apo shabate; këto gjëra janë hija e atyre që kanë për të ardhur; *por trupi është i Krishtit.*” (Kolosianëve 2:16-17)

Kuptimi i Krishtlindjes është se thelbi i përket Krishtit. Kjo do të thotë se rituali fetar është si hija e një personi madhështor dhe të lavdishëm. Le t’u largohemi hijeve dhe ta shohim në fytyrë personin (2 e Korintasve 4:6). “Djema, ruani veten nga idhujt (fetarë)!” (1 e Gjonit 5:21)



Gjithsecili dëshiron të jetë i lumtur. Faqja jonë lindi dhe u ndërtua për hir të lumturisë. Ne dëshirojmë që njerëzit kudo që janë të kuptojnë dhe të përqafojnë të vërtetën që Perëndia *përlëvdohet më tepër në ne, kur ne kënaqemi më tepër në Të*. Kemi grumbulluar më tepër se tridhjetë vjet materiale nga mesazhet dhe shkrimet e John Piper, duke përfshirë edhe përkthime në më shumë se dyzet gjuhë. Gjithashtu sigurojmë një burim të përditshëm materialesh të reja me shkrim, audio dhe video për t'ju ndihmuar të gjeni të vërtetën, qëllimin dhe kënaqësinë që nuk mbaron kurrë. Të gjitha këto janë në dispozicionin tuaj krejtësisht falas dhe kjo falë bujarisë së njerëzve që janë bekuar prej kësaj shërbese.

Nëse dëshironi më tepër materiale për lumturinë e vërtetë, apo nëse dëshironi të mësoni më tepër rreth punës tonë në DesiringGod, ju ftojmë të na vizitoni në faqen tonë [desiringGod.org](http://desiringGod.org).

---

[www.desiringGod.org](http://www.desiringGod.org)



**CIP Katalogimi në botim BK, Tiranë**

Piper, John

Lajm i mirë, gëzim i madh: 25 lexime devocionale  
për Adventin / John Piper; përkth. Asim Hamza;  
red. Linea Simeon. – Tiranë: Vision printing, 2021  
140 f. ; 13 x 20 cm.

Tit. origj.: Good news of great joy: 25 devotional  
readings for Advent

ISBN 978-9928-295-93-4

1. Bibla 2. Jezu Krishti 3. Meditimi

27 -31 -583